



Rishikimi i projeksioneve makroekonomike – nëntor 2024 –

dr. Anita Angellovska-Bezhoska,
guvernatorja



Konteksti global

- Sipas FMN-së, pas një periudhë të goditjeve ekstreme, **ekonomia globale po rimëkëmbet edhe** në gjysmën e parë të këtij viti:


- Pas **rritjes globale** prej 3,3% vitin e kaluar, për këtë vit vlerësohet rritje prej 3,2%, njëjtë si në projeksionet e prillit;
- Megjithatë, priten **realizime më të dobëta në një pjesë të vendeve të BE-së**, sidomos ekonomia gjermane, e cila ishte në recesion vitin e kaluar dhe për këtë vit vlerësohet stagnim;
- Inflacioni global** edhe më tej ngadalësohet, ku prej 6,7% u ul në 5,8% këtë vit, në kushtet e uljes së çmimeve botërore të produkteve primare, si dhe kushtet e shtrënguara financiare me politika monetare të shtrënguara;
- Megjithatë, **ngadalësimi është më i shpejtë në ekonomitë e zhvilluara** (2,6%), se në ekonomitë tjera (7,9%), kur ka ende rreziqe, sidomos lidhur me çmimet e shërbimeve, por edhe të mallrave, në prani të tensioneve gjeopolitike;
- Në përgjithësi **në krahasim me mesataren historike para pandemisë**, rritja globale është ende nën të dhe inflacioni është ende mbi të.

- Në këtë kontekst **FMN-ja këshillon**:

- lehtësim të kujdesshëm të **politikave monetare** kur ka rreziqe, veçanërisht në segmentin e tregut të punës;
- të konsolidohen gradualisht **politikat fiskale** dhe të rindërtohet hapësira fiskale për goditje të mundshme në të ardhmen;
- të përshpejtohen **reformat strukturore** për të rritur potencialin e rritjes dhe produktivitetin e ekonomive.


Rritja ekonomike, 2024-2026

norma reale e PBB-së, rritja mesatare vjetore për periudhën



Inflacioni global


norma mesatare sipas periudhave






Sipas parashikimeve afatmese të FMN-së, rritja globale do të ketë dinamikë të ngjashme dhe inflacioni do të vazhdojë të ngadalësohet

- **Për dy vitet e ardhshme, FMN-ja parashikon rritje prej 3,2% dhe 3,3%** (ngjashëm me këtë vit), gjë që tregon se rritja do të jetë më e dobët në krahasim me periudhën para pandemisë (3,8%)
- **Inflacioni global do të vazhdojë të ngadalësohet** duke u ulur në 4,3% dhe 3,6% në 2025 dhe 2026, me ngadalësim më të fortë në ekonomitë e zhvilluara, dhe pak më ngadalë në vendet me rritje të shpejtë dhe në zhvillim, gjë që tregon se në ekonomitë e zhvilluara do të kthehet në mesataren historike vitin e ardhshëm dhe në vendet tjera më vonë.
- **Krahasuar me projeksionet e prillit**, kryesisht nuk ka ndryshime të mëdha për rritjen globale, megjithëse ka rishikime në rënie për BE-në dhe perspektiva për inflacionin global është paksa më e favorshme.
- **Megjithatë, sipas FMN-së rreziqet për rritjen ekonomike botërore janë ende kryesisht në rënie, ndërsa për inflacionin janë kryesisht rritëse:**
 - Ngadalësim më i moderuar i inflacionit i ndjekur nga procesi më i ngadaltë i lehtësimit të politikës monetare;
 - Paqëndrueshmëri dhe kushte më të shtrënguara financiare;
 - Rritje më e dobët në ekonominë kineze;
 - Rritja e proteksionizimit dhe fragmentim më i fortë gjeo-ekonomik – edhe këtë vit numri i masave mbrojtëse është në rritje (përfshirë me nëntorin, janë futur 3650 masa të reja, nga të cilat 77% janë "të dëmshme")



Burimi: FMN-ja, Pasqyra ekonomike botërore.




Burimi: Pasqyra ekonomike botërore e FMN-së, Tetor 2024.



Çfarë do të thotë ky mjedis global për kërkesën e eksportit të prodhimeve dhe shërbimeve tona?

- **Rimëkëmbje graduale e kërkesës së huaj**, me vlerësime për rritje prej 0,8% këtë vit dhe përsheptim në 1,5% dhe 1,7% në dy vitet e ardhshme.
- **Në krahasim me projeksionet e prillit**, nuk ka ndryshim këtë vit, ndërsa ka rishikim minimal në rënie për vitin 2025 (1,6%), me pritshmëri më të dobëta për rritje në vendet e eurozonës, kryesisht në Gjermani.






Burimi: „Consesus Forecasts” dhe llogaritjet e BPRMV-së.



Çfarë do të thonë këto kushte të përgjithshme për çmimet tona të importit dhe eksportit?

- Pas rënies së theksuar të çmimeve të prodhimeve primare në vitin paraprak, **pjesëmarrësit e tregut dhe INF-të presin rënie të mëtejshme të çmimeve edhe këtë vit, dhe më pas rritje të moderuar të tyre në dy vitet e ardhshme.**
- Krahasuar me parashikimet e prillit priten kryesisht presione më të ulëta të çmimeve:**
 - Tek energjentët dhe ushqimi** pritet rënie më e thellë ose rritje më e ulët;
 - Tek inflacioni i huaj është bërë rishikim i vogël në ulje për vitin aktual, ndërsa vlerësimet për dy vitet e ardhshme janë të pandryshuara,** ndërkohë që ende pritet ngadalësimi i tij, respektivisht ulje në 3,2% këtë vit, dhe më pas 2,5% dhe 2,3% në dy vitet e ardhshme;
 - Te **metalet** lëvizjet janë në drejtime të ndryshme – lëvizje pak më pak të favorshme te nikeli, por më të mira te bakri, sidoqoftë çmime më të larta në krahasim me periudhën para pandemisë.
- Në përgjithësi, kjo tregon për kushte pak më të favorshme të tregtisë, megjithëse pasiguria mbetet, veçanërisht për shkak të tensioneve gjeopolitike.**





Supozime kryesore për parashikimet e ekonomisë vendase

- **Ekonomia globale dhe kërkesa e huaj** edhe më tej do të rikuperohen, megjithse konteksti i jashtëm është ende i pasigurt dhe i shoqëruar me rreziqe;
- **Çmimet e bursës** do të ulen edhe këtë vit, pas së cilit pritet kryesisht rritje e tyre e moderuar në periudhën e ardhshme;
- **Inflacioni do të vazhdojë të ngadalësohet** gjë që do të mundësojë lehtësim gradual monetar nga bankat qendrore në ekonomitë e zhvilluara, dhe me këtë edhe lehtësimin e kushteve financiare globale;
- **Pritet konsolidim fiskal në periudhën afatmesme**, në pajtim me Strategjinë Fiskale Afatmesme 2025-2029, sipas së cilës deficitit buxhetor prej 4,9% të PBB-së këtë vit duhet të reduktohet gradualisht në 3,0% të PBB-së në vitin 2027 dhe do të financohet nga burime të jashtme dhe të brendshme;
- **Pritet kontribut pozitiv nga investimet publike në infrastrukturë, por edhe nga investimet private në kushte të IHD-ve solide**;
- **Rritje solide në të ardhurat e disponueshme**, e mbështetur nga rritja reale më e fortë e masës së pagave, në kushtet e shtrënguara të tregut të punës dhe nga rritja e pensioneve.




Projeksioni afatmesëm makroekonomik

2024 – 2027



Projeksioni i PBB-së


- Në pajtim me rimëkëmbjen e ekonomisë globale pritet përshejtim gradual i ekonomisë së brendshme;
- Për këtë vit, rritja ekonomike është parashikuar në 2,3%, ndërsa për tjetrin 3,3%;
- Krahësuar me parashikimet e prillit, kjo nënkupton korigjim të moderuar në rënie për të dy vitet, kryesisht duke reflektuar lëvizjen më të dobët në gjysmën e parë të vitit, e cila, së bashku me rikuperimin më të ngadaltë të kërkesës së huaj, do të ndikonte në rritjen si për këtë, ashtu edhe për vitin e ardhshëm;
- Në afat të mesëm, në periudhën 2026 – 2027 pritet të vazhdojë rimëkëmbja e ekonomisë së brendshme, në pajtueshmëri me pritshmëritë për mjedis të jashtëm më të favorshëm dhe rritje të aktiviteteve investive lidhur me natyrën afatgjatë të ciklit të infrastrukturës publike;
- Megjithatë, **rreziqet** rreth projeksioneve janë ende kryesisht në rënie.






Projeksioni i PBB-së 2024 – 2026

- **Për sa i përket strukturës së rritjes**, si gjatë projeksionit të prillit, në periudhën afatmesme pritet kontribut pozitiv në kërkesën e brendshme dhe kontribut negativ në eksportet neto.
 - **Konsumi privat**– rritje mesatare prej **2,5%**, e mbështetur kryesisht nga rritja e të ardhurave të disponueshme dhe e kreditimit.
 - **Investimet** – rritje mesatare prej **8,2%**, e mbështetur nga investimet publike dhe private, në kushte solide të investimeve të huaja direkte dhe rritjes së kredisë.
 - **Aktiviteti i eksportit**– rënie në vitin 2024 dhe rritje në vitet e ardhshme, me kontribut pozitiv nga industria e automobilave, por edhe nga sektori tradicional i eksportit, në pajtim me rikuperimin gradual të kërkesës së huaj dhe situatën relativisht të favorshme të çmimeve të metaleve (rritje mesatare prej 2,8%).
 - **Importi** – në kushte të rritjes së eksporteve dhe kërkesës së brendshme, të cilat kanë komponentë të lartë importi, pritet rritje mesatare prej **3,9%**.





- Norma e inflacionit**
(në %)





Krahasimi i parashikimeve të PBB-së dhe inflacionit në ekonominë tonë

Krahasim i parashikimeve për PBB-në dhe inflacionin për Maqedonisë e Veriut nga organizata të ndryshme


Organizata	Muaji i publikimit	Rritja reale e PBB-së, %			Inflacioni (norma mesatare, %)		
		2024	2025	2026	2024	2025	2026
FMN	tetor 2024	2,2	3,6	3,8	3,3	2,3	2,0
Banka Botërore	tetor 2024	1,8	2,5	3,0	3,5	2,8	2,0
Komisioni European	maj 2024	2,9	3,0	-	3,0	1,9	-
BERZH	shtator 2024	2,2	3,5	-	-	-	-
Consensus Forecast	tetor 2024	2,1	3,0	-	3,5	2,7	-
Ministria e Financave	shtator 2024	2,1	3,7	4,0	3,5	2,2	2,0
Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut	tetor 2024	2,3	3,3	4,0	3,5	2,5	2,0

Burimi: FMN-ja, Pasqyra ekonomike botërore, tetor 2024; Banka Botërore, Raport i rregullt ekonomik për Ballkanin Perëndimor, vjeshtë 2024; Komisioni European, Parashikimet për ekonominë europiane, pranverë 2024; BERZH, Perspektivat ekonomike rajonale, shtator 2024; Consensus Forecast, tetor 2024; Ministria e Financave, Strategjia Fiskale 2025-2029, shtator 2024; dhe Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut, tetor 2024.



Bilanci i pagesave - llogaria rrjedhëse -


- **Pozicioni i jashtëm i ekonomisë ende pritet të jetë kryesisht i favorshëm dhe i qëndrueshëm në periudhën afatmesme.**
- **Pas suficitit të arritur një vit më parë (0,4%), këtë vit vlerësohet deficit i moderuar i llogarisë rrjedhëse prej 2,1% të PBB-së, i cili kryesisht lind nga normalizimi i transfertave private pas niveleve të larta të arritura në vitin 2023 (duke ulur pjesëmarrjen e tyre në PBB).**
 - Në lidhje me muajin prill, deficitin është pak më i ulët (2,4%), kryesisht si rezultat i suficitit më të lartë të shërbimeve, si dhe i bilancit pak më të mirë tregtar, i ndikuar plotësisht nga komponenti i energjisë.
- **Për periudhën e mbetur të projeksionit, 2025 – 2027, është parashikuar deficit në llogaritë rrjedhëse mesatarisht në 2,2% të PBB-së - mesatare para pandemisë, në kushte të:**
 - shtrëngimit gradual të bilancit tregtar, në kushtet e rritjes së eksporteve dhe pritjeve të qëndrueshme për çmimet e energjisë;
 - por, në të njëjtën kohë pritshmëritë për rritjen e importit të shërbimeve (për shkak të aktiviteteve ndërtimore lidhur me ndërtimin e korridoreve 8 dhe 10-d) dhe rënie graduale e hyrjeve neto në të ardhurat sekondare.





Bilanci i pagesave - llogaria financiare -

- **Flukset hyrëse në llogarinë financiare në periudhën 2024 - 2027 pritet që mesatarisht të jenë 2,7% e PBB-së, kryesisht në formën e investimeve të huaja direkte dhe huamarrjes së jashtme të shtetit.**
- Duke qenë se do të jenë më të larta se deficitin e llogarisë rrjedhëse (2,2% e PBB), do të mundësojnë rritje të mëtejshme **të rezervave devizore.**
- Gjatë gjithë periudhës së projeksionit, **treguesit e mjaftueshmërisë së rezervave devizore janë ende në zonën e sigurt.**







Rritja e depozitave dhe kredive

- **Sistemi bankar vazhdon të ofrojë mbështetje solide kreditore** – në tremujorin e tretë të 2024 rritja e kredisë është 7,5% në bazë vjetore (6,1% sipas projeksionit të prillit). Megjithatë, **deri në fund të 2024**, pritet rritje e qëndrueshme kreditore prej 7,5%.
- **Në periudhën afatmesme, 2025 – 2027, pritet dinamikë e ngjashme (7,2%)**, në kushtet e pozicionit solid të kapitalit dhe likuiditetit të bankave, në pajtim me pritshmëritë për lehtësimin gradual të kushteve financiare, përshpejtimin e rritjes ekonomike dhe stabilizimin e pritjeve të subjekteve ekonomike.
- **Depozitat, si burimi më i rëndësishëm i financimit, në tremujorin e tretë të 2024, realizuan rritje vjetore prej 8,4%** (9,0% sipas projeksionit të prillit), në kushte më të favorshme për kursim, rritje të të ardhurave të disponueshme të popullsisë, pritshmëri të qëndrueshme dhe forcimi i besimit.
- **Në fund të vitit 2024, pritet rritje solide vjetore të depozitave prej 7,9%**, ndërsa **në afat të mesëm** për periudhën prej 2025 deri më 2027 për rreth **mesatarisht 7,7%**.

Rritja e kredive



Rritja e depozitave





Përmbledhje

- **Realizimet e deritanishme në të gjitha segmentet makroekonomike janë kryesisht në pajtim me pritjet;**
- **Sipas parashikimeve të fundit të FMN-së, në afat të mesëm, ekonomia globale do të vazhdojë të rritet me ritëm të qëndrueshëm dhe inflacioni global do të vazhdojë të ulet;**
- Në pajtim me rritjen te partnerët tanë tregtarë dhe disa faktorë stimulues të brendshëm, pritet që **ekonomia vendase** do të rritet me normë prej 2,3% këtë vit dhe 3,3% në vitin e ardhshëm;
- Pritet që me stabilizimin e çmimeve botërore dhe politikës së kujdesshme monetare, do të mundësojnë ngadalësim të mëtejshëm të inflacionit, ndërsa në afat të mesëm do të kthehej në mesataren historike prej 2%;
- Me flukse neto solide të parashikuara në llogarinë financiare që do të tejkalojnë deficitin e llogarisë rrjedhëse, pritet rritje e mëtejshme e **rezervave devizore**, si garanci për stabilitetin e kursit të këmbimit;
- Megjithatë, **mjedisi global mbetet i pasigurt dhe i paparashikueshëm**, që krijon rreziqe për rritjen ekonomike, inflacionin dhe pozicionin e jashtëm, duke theksuar nevojën për politika të brendshme makroekonomike dhe strukturore të matura;
- **Në kushte të ngadalësimit të ndjeshëm të inflacionit të brendshëm dhe treg të favorshëm devizor, po me rreziqet ende të pranishme, Banka Popullore filloi me normalizimin e matur të politikës monetare.** Norma e interesit të bonove të thesarit është ulur në dy raste (në shtator dhe tetor) për gjithsej 0,5 p.p., në nivelin prej 5,80%. Normat e tjera të interesit, depozitat njëditore dhe depozitat e disponueshme 7 ditore, mbeten të pandryshuara në nivelet prej 4,20% dhe 4,25%, respektivisht, dhe me këtë u ruajt qasja e kujdesshme e ushtrimit të politikës monetare;
- Duke pasur parasysh strategjinë monetare të kursit të qëndrueshëm të këmbimit të denarit ndaj euros, ndryshimet në politikën monetare të brendshme reflektojnë edhe pozicionimin e politikës monetare të Bankës Qendrore Europiane, e cila ka ulur normën e interesit në tre raste deri më tani;
- ***Banka Popullore me kujdes, në baza ditore, i mbikëqyr të dhënat dhe rreziqet makroekonomike dhe, si deri më tani, do të marrë të gjitha masat e nevojshme, duke përdorur të gjitha instrumentet në dispozicion, me qëllim ruajtjen e stabilitetit të kursit të këmbimit dhe stabilizimin e inflacionit në afat të mesëm.***



*JU FALEMINDERIT PËR
VËMENDJEN!*